REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 911/20
Datë/Datum. 19.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Hasim Krasniqi	13.11.2020	19.11.2020	911/20,

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:**09.11.2020**, grupi i OE "**NNP Engineering & P&I Sh.p.k. & Gashi ing Sh.p.k" Viti**, ka parashtruar ankesë me nr: **911/20,** kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE "**Dajting Sh.p.k. & N.N.P ATC Com Sh.p.k" Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Ndertimi i Shtepise se Kultures Imri Curri - Hani i Elezit (faza e II)** me nr. të prokurimit: **659-20-4841-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Hani i Elezit.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, lloji i kontratës: **punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **499,983.00 €.**

Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE Ankesa 911/20

Dispozitat e shkelura sipas, OE i OE "**NNP Engineering & P&I Sh.p.k. & Gashi ing Sh.p.k" Viti**, e cila ka parashtruar ankesë me nr: **911/20,** janë:

Neni 1, të LPP-së,
Neni 6, të LPP-së,
Neni 7, të LPP-së,
Neni 59, të LPP-së,
Nenin 69, të LPP-së,
Neni 71 të LPP-së,
Nenit 72 të LPP-së.

pikat e ankesës:

OE ankuese ka parashtruar ankes lidhur me arsyjen e elminimit të saj nga AK që nderlidhen me kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kerkeses qe nderlidhen me, mos ofrimin e qasjes ne dokumetet publike, planin dinamik, kontrates se gjeodetit z.Ferid Ahmeti, faturave me numrin e njejte, lidhur me qarkullimin respektivisht vleren e kontratave/referencave, kerkesen per sigurim te tenderit ne vlere prej 10,000.00 € si dhe pretendimin se oferta e grupit te OE ankuese është më e lirë se sa oferta e grupit të OE-ve të rekomanduar për kontratë.

-Per me teper referojnu deklarates ne ankesen e paraqitur pran OSHP-se nga ana e operatorit ankues nr.911/20.

nr.911/20.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta me pretendimet e parashtruara nga OE me kërkesen për rishqyrtim në AK.

KRITERET PËR VLERËSIM

FDT 5.2 Kushtet dhe kërkesat e dërgesës

Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: në muaj ***12*** *ose në ditë ose fillim përfundim* ***projekti duhet te kryhet brenda vitit 2021, jo me shume se 12 muaj***

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.4) Kërkesat-Kapaciteti teknik dhe profesional

Operatori duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme të kryerjes së punëve të lemise se kerkuar (meremetim,suvatim etj min.438,000 €, sist.elektrik min.73,000 €, ujesjelles dhe kanalizim 73,000 €, sanitari 73,000 €, dyer dhe dritare 73,000 €) për 3 vite te fundit nga momenti i shpalljes se NJK, me vlere min.730,000 Euro. Lideri i grupit duhet ti plotesoj se paku 60 % te puneve te kerkuara.

Lista e pajisjeve të punës – min.1 eskavator min.9 Ton , 1 kamionë kiper min.10 Ton, 1 ngjeshes min.9 Ton, 1 Autocisterna (kamion per pastrim te rrugeve me peshe bartese min.10000 lit uje), 1 kamion me kran min.10 Ton ; 1 autokorpë min.12 metra, , skele per hapesiren min.3500 m2, min.3 pompa per suvatim, 1 kran statik etj

Menaxheri i projektit te jetë inxhinier i diplom. i ndërtimtarisë apo MSc i ndërtimtarisë - konstruktiv (vendim nga kompania) - 5 vite pervoje pune pas diplomimit, 1 arkitekt i dipl ose bch.arkitektures - 3 vite pervoje pune pas diplomimit , 1 inxh.diplomuar i ndertimtarise (hidros) ose Bsc.ndertimtarisë (hidro) - 3 vite pervoje pune pas diplomimit; 1 inxh.diplomuar i makinerise ose MSc.i makinerise - 3 vite pervoje pune pas diplomimit, 1 inxh.diplomuar i elektros ose MSc. i elektros - 3 vite pervoje pune pas diplomimit, 1 inxh.gjeodezise ose BSc.gjeodezi (i licencuar nga AKK-ja) - 3 vite pervoje pune pas diplomimit;

Plani dinamik

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Të paraqitet lista e projekteve të realizuara të punëve në lëmin e kërkuar (Referenca ose raporte pranimi)

Dëshmi të makinerisë për ekzekutimin e punëve te bashkangjiten (librezat e mjeteve, DUD-at, marreveshje per shfrytezim të pajisjeve etj)

Lista per inxhineret apo Bacheloret dhe te bashkangjiten Diploma e inxhinierit (menaxherit), kontratat ose parakontratat e punës për inxhiniere ose bachelor sipas kushteve te kerkuara, referencat per pervojen e punes se natyres se inxhinierit dhe CV e inxhinierit.

Plani dinamik i detajizuar (i vulosur dhe nenshkruar nga OE)

IV.2) KRITERET E DHËNIE

Çmimi më i ulët

IV.3.4) Siguria e tenderit

A është e nevojshme siguria e tenderit: Po x Jo □

Vlera e sigurisë së tenderit ***10,000.00 Euro*** *-Vlefshmëria e sigurisë së tenderit ne ditë* ***120*** *apo muaj*

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit dhe letren standarte mbi eliminimin, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Grupi i OE "NNP Engineering & P&I Sh.p.k. & Gashi ing Sh.p.k" Viti: nuk i plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktue i Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye **Ju mungojnë :**

Kerkesa: Operatori duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme të kryerjes së punëve të lemise se kerkuar (meremetim,suvatim etj min.438,000 €, sist.elektrik min.73,000 €, ujesjelles dhe kanalizim 73,000 €, sanitari 73,000 €, dyer dhe dritare 73,000 €) për 3 vite te fundit nga momenti i shpalljes se NJK, me vlere min.730,000 Euro. Lideri i grupit duhet ti plotesoj se paku 60 % te puneve te kerkuara;

Deshmia: Të paraqitet lista e projekteve të realizuara të punëve në lëmin e kërkuar (Referenca ose raporte pranimi)

1. *Ju si Konzorcium, nuk e permbushni kriterin e kerkuar te AK-së, ku sipas sqarimeve shtese te dt.12.10.2020; 15.10.2020; 16.10.2020; 19.10.2020; 21.10.2020; 22.10.2020 ju si OE nuk na i keni deshmuarse e permbushni kriterin sipas sqarimeve tuaja te listes suaj te dt.21.10.2020:*

Kerkesa e AK-së	*Vlera e kontratave nga OE*	*Permbushja Po/Jo*
Referenca te natyres se kontrates		
-Meremetim, suvatim – min.438,000 €	*224,942.80 €;*	*JO*
-Kanalizim dhe ujesjelles – min.73,000 €	*64,580.00 €*	*JO*
-Sistem elektrik – min 73,000 €	*0.00 €*	*JO*
-Sanitari - min. 73,000 €	*0.00 €*	*JO*
-Dyer dhe dritare – min.73,000 €	*20,000.00 €*	*JO*

Pra, si Lider duhet ti permbush 60% te puneve te kerkuara. Ku ju nuk e permbushni kriterin e kerkuar shiko kriterin Lideri i grupit duhet ti plotesoj se paku 60 % te puneve te kerkuara;

Nuk jane pune te kerkuara ura, rrethojat e shkollave!

Poashtu lidhje me deshmine tuaj ju keni prezantuar fature fiktive me nr.07-20 qe e njejta fature eshte paguar nga Komuna Hani i Elezit me dt.07.07.2020 ne vlere 22,173.62 €, poashtu si deshmi pagese, ju keni prezantuar poashtu Faturen e dt.22.03.2020 me numer te njejte 07-20 e leshuar per NPN. Vision Projekt – Gjilan me shume 45,000.00 €.
Kjo lidhet me dy kontratat dhe referencat e dyshimta!!?

Si eshte e mundur te leshohet 2 (dy) fatura me numer te njejte, kjo nuk quhet ndryshe pos Fature fiktive qe e sanksionojne ligjet e Kosovës (faksifikimi, mashtrimi etj).

2. *Ju si konzorcium Planin dinamik te detajizuar (te nenshkruar dhe vulosur) te kerkuar per 12 muaj (apo 365 dite kalendarike), kurse ju e keni prezantuar 480 ditë pune, qe po te zberthehet ne dite kalendarike eshte 617 dite kalendarike, apo afro dy here e keni tejkaluar kerkesen e AK-së qe ka qene 12 muaj. Pra e keni sjellur planin dinamik afer 2 vite!*
3. *Kontrata e inxhinierit te gjeodezise – Ferid Ahmeti, i cili ne kontraten e tij nuk ka asnje vlere pagese qofte muajore apo me orë, por eshte pa vlere fare, qe sipas Ligjit te Punes nuk jane valide kontratat pa vlerë.*
   Kontrata e inxhinierit bie ndesh me Ligjin e Punes 03/L-212 me nenin 11 te Ligjit te Punes (Permbajtja e kontrates se punës).
4. *Nuk e plotesoni kriterin e kerkuar skele min.3500 m2, qe eshte kerkuar te Lista e pajisjeve/mjeteve,*

qe nuk e permbushni kriterin e kerkuar te AK-së.

Çdo OE qe tenton te bej mashtrime, falsifikime etj bie ndesh me Ligjet ne fuqi te Republikës së Kosovës!

Neni 390 - Falsifikimi i dokumenteve thote (citim):
1.Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.
2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, regjistrin publik apo zyrtar ose ndonjë regjistër tjetër që ruhet në bazë të ligjit, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.
3. Kushdo që e kryen veprën e paraparë në paragrafin 1 ose 2 të këtij neni si anëtar i grupit të njerëzve, dënohet me gjobë dhe burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Neni 323-Mashtrimi
Paragrafi 2 i Nenit 323 te KPRK-se thote (citim):
2. Nëse qëllimi i mashtrimit është përfitimi i dobisë së kundërligjshme nga fondet publike ose institucionet publike, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.

Neni 99 i LPP-së:
Neni 99.2 i LPP-se thotë(citim) :
Në bazë të një kërkese me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Komisioni i vlerësimit ka rekomanduar ZP që me kontratë të shpërblehet grupi i OE: **"Dajting Sh.p.k. & N.N.P ATC Com Sh.p.k" Prishtinë**, me çmim me te lirë në vlerë prej**: 477,448.53 €uro.**

Menaxheri i prokurimit, ka aprovuar rekomandimin e komisionit të vlerësimit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Qasja ne dokumentacionet te cilat gjenden në platformen e e-prokurimit që janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitura nga operatoret ekonomik pjesmarres në këtë aktivitet të prokurimit.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

Duke u bazuar në shkresat e lëndes, mendoj se operatori ekonomik ankues nuk është palë interesi në këtë aktivitet të prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "NNP Engineering & P&I Sh.p.k. & Gashi ing Sh.p.k" Viti -Ankesa 911/20

Duke u mbeshtetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

Përgjigjje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 59, dhe 72 të LPP-së, me arsytimin se:

"OE ankuese ka parashtruar ankes lidhur me arsyjen e elminimit të saj nga AK që nderlidhen me kerkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kerkeses qe nderlidhen me, mos ofrimin e qasjes ne dokumetet publike, planin dinamik, kontrates se gjeodetit z.Ferid Ahmeti, faturave me numrin e njejte, lidhur me qarkullimin respektivisht vleren e kontratave/referencave, kerkesen per sigurim te tenderit ne vlere prej 10,000.00 € si dhe pretendimin se oferta e grupit te OE ankuese është më e lirë se sa oferta e grupit të OE-ve të rekomanduar për kontratë."

Lidhur me pretendimin e grupit të OE ankues rrethkerkeses qe nderlidhet me, mos ofrimin e qasjes ne dokumetet publike eksperti shqyrtues sqaron se përfaqsusit e OE "Engineering"-Viti ka bërë kërkesë për qasje me dt.26/10/2020 në ora 6:31(18:31), pas orarit zyrtar të punës, ndersa AK e ka njoftuar përmes e-mailit të datës 28.10.2020 në ora 12:24, përmes të cilit OE ankuse është njoftur se i mundësohet qasja në të njëjten ditë, me daten 28.10.2020 ne ora 15:00.

Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lendes eksperti shqrtues konstaton se AK ka parashtraur kërkesat dhe dëshmit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, si vijon:

Kërkesa:

Operatori duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme të kryerjes së punëve të lemise se kerkuar (meremetim,suvatim etj min.438,000 €, sist.elektrik min.73,000 €, ujesjelles dhe kanalizim 73,000 €, sanitari 73,000 €, dyer dhe dritare 73,000 €) për 3 vite te fundit nga momenti i shpalljes se NJK, me vlere min.730,000 Euro. Lideri i grupit duhet ti plotesoj se paku 60 % te puneve te kerkuara.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Të paraqitet lista e projekteve të realizuara të punëve në lëmin e kërkuar (Referenca ose raporte pranimi)

Ndersa, grupi i OE ankuese së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listat e kontratave për të tre antaret e konzorciumit, listen e kontratave/aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2019 për antarin e konzorciumit Gashi ing Sh.p.k, në vlerë totale prej 1,197,669.95 €, listen e kontratave/aktiviteteve të realizuara nga viti 2014-2019 për antarin e konzorciumit P&I Sh.p.k., e cila listë nuk përmban vlerë totale por nëse mbledhen të gjitha vlerat e kontratave/aktiviteteve të paraqitura në listë vlera e tyre është mbi 7 milion si dhe listen e kontratave/aktiviteteve të realizuara nga viti 2015-2020 për liderin e konzorciumit **NNP Engineering**, në

vlerë totale prej 3, 922, 333.86 €, mirëpo me qenë se këkesa e AK ka qenë decidive që operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme të kryerjes së punëve të lemise se kerkuar **(meremetim,suvatim etj min.438,000 €, sist.elektrik min.73,000 €, ujesjelles dhe kanalizim 73,000 €, sanitari 73,000 €, dyer dhe dritare 73,000 €)** për 3 vite te fundit nga momenti i shpalljes se NJK, **me vlere min.730,000 Euro, nga të cilat lideri i grupit duhet ti plotesoj se paku 60 % te puneve te kerkuara,** me qenë se lideri i grupit të OE ankues NNP Engineering ka përfshirë në listë kontrata të natyres së këkuar, të nënshkruar me operator privat, AK respektivisht komisioni i vlerësimit ka kërkuar sqarime shtese përmes komunikimit të ndersjell me përfaqsusit e NNP Engineering, përmes e-mailave te dt.12.10.2020; 15.10.2020; 16.10.2020; 19.10.2020; 21.10.2020 dhe 22.10.2020 me qëllim që të sqaroj vlerat e kontratave dhe për të konstatuar se lider i grupit NNP Engineering e ploteson se paku 60 % te puneve te kerkuara sipas kërkesës së AK, mirëpo nga komunikimet dhe dëshmit e ofruara vërhet se grupi i OE ankuese respektivisht lideri i grupit NNP Engineering ka dështuar të ofroj dëshmi se ka realizuar 60% të vlerës min. 730,000 Euro sipas kërkesës së AK. Andaj pretendimi i grupit të OE ankuese në këtë pikë **nuk është i bazuar.**

Eksperti shqyrtues duke pas parasysh arysyjet e eliminimit të cekura nga AK në letren standarte për eliminim *(të paraqitura në faqen 3 dhe 4 të këtij raporti)* dërguar grupit të OE ankuese, konstaton se AK ka parashtraur kërkesen dhe dëshmin në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, si vijon:

Kërkesa:

*Lista e pajisjeve të punës – min.1 eskavator min.9 Ton , 1 kamionë kiper min.10 Ton, 1 ngjeshes min.9 Ton, 1 Autocisterna (kamion per pastrim te rrugeve me peshe bartese min.10000 lit uje), 1 kamion me kran min.10 Ton ; 1 autokorpë min.12 metra,**skele per hapesiren min.3500 m2**, min.3 pompa per suvatim, 1 kran statik etj*

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmi të makinerisë për ekzekutimin e punëve te bashkangjiten (librezat e mjeteve, DUD-at, marreveshje per shfrytezim të pajisjeve etj)

Ndersa, grupi i OE ankuese së bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar listat e mjeteve, marrëveshjet për shfrytëzim të makineris, kopje të librezave, kopje të DUD-ave doganor, mirëpo nuk ka dorëzuar dëshmi se posedon skele per hapesiren min.3500 m2 sipas kërkesës së parashtruar nga AK. Andaj në këtë pikë AK më të drejte e ka eliminuar grupit e OE ankuese.

AK ka parashtraur kërkesen dhe dëshmin në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, si vijon:

Kërkesa:

Menaxheri i projektit te jetë inxhinier i diplom. i ndërtimtarisë apo MSc i ndërtimtarisë - konstruktiv (vendim nga kompania) - 5 vite pervoje pune pas diplomimit, 1 arkitekt i dipl ose bch.arkitektures - 3 vite pervoje pune pas diplomimit , 1 inxh.diplomuar i ndertimtarise (hidros) ose Bsc.ndertimtarisë (hidro) - 3 vite pervoje pune pas

diplomimit; 1 inxh.diplomuar i makinerise ose MSc.i makinerise -3 vite pervoje pune pas diplomimit, 1 inxh.diplomuar i elektros ose MSc. i elektros -3 vite pervoje pune pas diplomimit, ***1 inxh.gjeodezise ose BSc.gjeodezi (i licencuar nga AKK-ja) - 3 vite pervoje pune pas diplomimit;***

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Lista per inxhineret apo Bacheloret dhe te bashkangjiten Diploma e inxhinierit (menaxherit), ***kontratat ose parakontratat e punës për inxhiniere ose bachelor sipas kushteve te kerkuara****, referencat per pervojen e punes se natyres se inxhinierit dhe CV e inxhinierit.*

Ndersa, grupi i OE ankuese së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar kopjen e kontrates mbi vepren per inxhinierit e gjeodezise –z. Ferid Ahmeti, por ne kontraten e tijmbi vepren nuk ka asnje vlere pagese qofte mujore apo me orë, është kontrat pa vlerë fare, si e tillë kontrata nuk ëhtë konform nenit 11 të Ligjin e Punes 03/L-212 dhe sipas Ligjit te Punes kontratat pa vlerë nuk jane valide. Andaj pretendimi i grupit të OE ankuese në këtë pikë **nuk është i bazuar.**

AK ka parashtraur kërkesen dhe dëshmin në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, si vijon:

Kërkesa:

Plani dinamik- Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: ***në muaj 12 ose në ditë -projekti duhet te kryhet brenda vitit 2021, jo me shume se 12 muaj.***

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Plani dinamik i detajizuar (i vulosur dhe nenshkruar nga OE)

Ndersa, grupi i OE ankuese së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar planin dinamik të vulosur dhe nënshkruar lideri i grupit "NNP Engineering" mirëpo plani dinamik është hartuar për kohëzgjatje prej 24 muaj respektivisht 480 ditë pune, në kundërshtim me kerkesen e parashtruar nga AK në dosjen e tenderit që fillimi dhe përfundimi i kontrates do të bëhet brenda 12 muaj respektivisht ***projekti duhet te kryhet brenda vitit 2021, jo me shume se 12 muaj.*** Andaj pretendimi i grupit të OE ankuese në këtë pikë **nuk është i bazuar.**

Përgjigjje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e grupit të OE ankuese se AK në kundërshtim me njoftimin e KRPP-së të cilët kanë njoftuar AK-të, që në kushte pandemie maximumi i kërkesës së lejuar për sigurim të tenderit është 1% e vleres së projektit ka parashtruar këkesen për sigurimin e tenderit në vlerë prej 10,000.00 €, me te cilen kërkesë janë dëmtuar të gjithë pjesmarresit në këtë aktivitet, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i grupit të OE ankuese është dashur të parashtrohet në fazen e njoftimit për kontratë para dorëzimit të ofertave e jo në këtë fazë, po ashtu eksperti shqyrtues konstaton se i njejti grup i OE-ve së bashku me dosjen e tenderit

respektivisht oferten kanë dorëzuar edhe sigurin e tenderit konformë kërkesës së AK-së. Andaj pretendimi i grupit të OE ankuese në këtë pikë **nuk është i bazuar.**

Përgjigjje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin e grupit të OE ankuese se oferta e tyre është më e lirë se sa oferta e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se autoritet kontraktues respektivisht komisioni vlerësues është i obliguar që me rastin e vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave të zbatojn paragrafin 1.1 te pikes 1 te nenit 60 të LPP-së ku thuhet se: "*Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar **tenderin e përgjegjshëm** me çmimin më të ulët*".

Përgjigjje në Pretendimi nr.4

Lidhur me pretendimet e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues **nuk janë të bazuara** sepse OE ankuese pretendimet ne fjale vetem i ka cekur siperfaqsisht pa sqaruar dhe pa dhenë ndonjë fakt rreth shkeljes se ketyre neneve në deklaraten e ankeses se dorëzuar, po ashtu me nenin 69 dhe 71 të LPP-së rregullohen respektivisht udhëzohen autoritetet se si mund të kërkojnë dhe vendosin në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë kërkesat minimale si dhe cilat dëshmi duhet të kërkohen-dorëzohen nga OE lidhur me aftësit teknike dhe/ose profesionalekontraktuese si dhe udhëzohen respektivish sqarohet se si një grup i OE mund të ftohet të marr pjesë respektivisht sqarohet forma se si duhet të formohen grupet e operatorev ekonomik, gjatë ushtrimit/zhvillimit të një aktiviteti të prokurimit.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **hudhet poshtë si e pa bazuar,** si dhe rekomandon të mbetet në fuqi vendimi mbi njoftimin për dhënie të kontrates i AK-së.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Komuna Hani i Elezit.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **"NNP Engineering & P&I Sh.p.k. & Gashi ing Sh.p.k" Viti.**